



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 33 Datë 10. 04. 2017

**PËR TRANSFERIMIN E AUTORIZIMIT (MIRATIM NË PARIM)
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR**

Në mbështetje të Kreut VII , nenit 50, pikës 5 , gërmës b të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore “ autorizimet, lejet dhe konçesionet për përdorimin e ujrave nuk mund të transferohen pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë ,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :

V E N D O S I :

- 1- Të miratojë kërkesën e subjektit “ INSTITUTI DEKLIADA ALB”sh.p.k. i cili është paisur me autorizim (Miratim në parim) Nr. Prot. 90/20,datë 23.02.2017,(Miratuar me vendim Nr.20,datë 13.02.2017 të KBU Drin-Bunë) për përdorim të burimit ujor Lumi Veleshices, degë e Lumit Drin i Zi , për prodhim energjie elektrike për HEC ZALL-KALIS ,në Njësinë Administrative Kalis , Bashkia Kukës, Qarku Kukës , për transferimin e këtij autorizimi subjektit “EL-PROM”sh.p.k.
- 2- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI

Kryetar

Paulin RADOVANI

